



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.62/2021

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar, Muhamet Rexha dhe Fejzullah Rexhepi, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e B. H., kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Prishtinës nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), A.nr.855/2021 datë 06.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 09.11.2021 merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e B. H., kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Prishtinës nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.855/2021 datë 06.11.2021.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.855/2021 datë 06.11.2021, është refuzuar si i pabazuar apeli i parashtruar nga B. H., kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Prishtinës nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me nr. 2948-2021 datë 03.11.2021 e cila pretendon se në vendvotimin në Shkollën Filllore "... në ..., i mungon

një numër i votave dhe përkundër pritjes e njëjta ka vetëm 10 vota, ndërsa edhe në fshatin ..., ku ka vetëm një vendvotim nuk ka asnjë vote edhe pse ka familjarë dhe miq që i pohojnë se kanë votuar për të.

Kundër vendimit të lartpërmendur, B. H., kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Prishtinës nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë pa përcaktuar shkaqet ligjore për të cilat mund të paraqitet ankesa por nga përmbajtja del se ankesa është paraqitur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që të aprovohet ankesa dhe t'i mundësohet rinumërimi i pasi që konsideron se votat e saja janë keqnumëruar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur PZAP nëpërmes së cilës kundërshtohen thëniet ankimore dhe propozon që ankesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore dhe të përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa e B. H., kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Prishtinës nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.855/2021 datë 06.11.2021, është e pabazuar.

Nga vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa A.nr.855/202, datë 06.11.2021, i goditur me ankesë, rezulton se është refuzuar si i pa bazuar apeli i tani paraqitëses të ankesës, me arsyetim se e njëjta nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me pretendimet e saj të paraqitura në apel, ndërsa ato pretendime që gjoja konfirmojnë ekzistimin e votave në vendvotime të caktuara. Ankuesja e mbështetë këtë me pohimet e personave të caktuar në shkrimet e përdoruesve të rrjeteve sociale të cilat nuk paraqesin bazë ligjore për të konstatuar pa rregullsi gjatë procesit të numërimit të votave në vendvotimin e sipër cituar dhe për rrjedhojë as referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor të ankueses.

Në një gjendje të tillë faktike, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, të marrë lidhur me refuzimin e apelit, të paraqitur nga i lartë përmenduri, nga se, në mungesë të provave dhe dëshmime të cilat paraqitësja e apelit ka pas për detyrë ti prezantoj së bashku me apelin, nuk mund të merret vendim aprovues për një apel të tillë. Në kuptim të nenit 117.3 të Ligjit për Zgjedhjet e përgjithshme dhe Lokale, vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP, mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse, në bazë të cilave në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, PZAP mund të urdhëroj rinumërimin e fletëvotimeve në një vendvotim apo qendër votimi si dhe shqyrtimin e materialit votues si pjesë të hetimeve për ankesën ose apelin.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin pretendimet ankimore të paraqitësit të ankesës përkitazi me konstatimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, mirëpo këto pretendime ankimore u refuzuan si të pabazuara nga se as në ankesë, paraqitësja e saj, nuk ka ofruar dëshmi e prova të qarta lidhur me pretendimet e saja se në vend votimet e cituara më lartë votat e saja janë keq numëruar.

Ankuesja, duke mos paraqitur në ankesë, prova të qarta dhe bindëse, për manipulimin e keq numërimit të votave të saj në vend votimet e cituara më lartë, edhe Gjykata Supreme e Kosovës gjen se me pretendimet e tilla ankimore, paraqitësja e tyre, nuk ka arritur që të vë në dyshim gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë nga ana e organit vendimi i të cilit kontestohet, kështu që u refuzuan si të pabazuara pretendimet ankimore përkitazi me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Për arsyet e paraqitura më lart, e në pajtim me nenin 118 pika 4 të Ligjit mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

AA.nr.62/2021, datë 09.11.2021

Kryetar i kolegjit

Beshir Islami